



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 16 Datë 12 / 09 / 2018

**“Për
Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Basenit Ujor Mat Nr. 78, Datë 22/02/2017, “Për Miratimin
e Lejes për Rehabilitimin e Rrjedhës së Ujit në Lumin Mat”,
Subjektit “Paluca Sa” Sh.p.k”.**

Në mbështetje të shkronjës “d”, të nenit 109, nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit, nr. 01, datë 13.01.2010, “Për ndalimin e përkohshëm të dhënies së lejeve të reja për shfrytëzimin e zhavorreve në shtretërit e lumenjve”, vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 01, datë 07.07.2011, “Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve”, me propozimin e Kryetarit, Këshilli I Basenit Ujor Mat

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 78, datë 22.02.2017, “Për miratimin e Lejes për rehabilitimin e rrjedhës së ujit në lumin Mat”, subjektit “PALUCA SA” sh.p.k
2. Ngarkohet Agjensia e Basenit Ujor Mat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gjergj PRENDI